

RAPORT MJEDISOR:
Objekti: "Mbrotjtje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, loti 2"

RAPORT I NDIKIMIT NE MJEDIS

OBJKEKTI:
**"MBROJTJE NGA GERYERJET E LUMIT DEVOLL NE DESARE, LOTI
2"**

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
1.1 NDIKIMET NE MJEDISE GJATE FAZES NDERTIMIT DHE PAS	3
1.2 QELLIMI I PROJEKTIT	3
2. VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE KARAKTERISTIKAT	3
2.1 TË PERGJITHSHME	3
2.2 RELIEVI.....	4
2.3 ZONAT TONA TË INTERESIT:.....	4
2.4 RILEVIMI TOPOGRAFIK	4
2.5 TE DHENAT HIDROLOGJIKE DHE KLIMATIKE	4
2.6 HIDROLOGJIA.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3. PUNIMET E PROPOZUARA DHE METODA E KRYERJES SE TYRE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1 TË PERGJITHSHME	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.2 PERZGJEDHJA E VENDIT PER NGRITJEN E KANTIERIT	7
3.3 MAKINERITË DHE PAJISJET KRYESORE QË DO TË PËRDOREN PËR PROJEKTIN	8
4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE MUNDSHME NE ZONEN E PROJEKTIT	9
4.1 TOKA	10
4.2 NDOTJA E UJIT	10
4.3 NDOTJA E AJRIT	10
4.4 ZHURMAT	10
4.5 FLORA/ FAUNA	11
4.6 SOCIALE-ECONOMIKE	11
5. QËLLIMET E MONITORIMIT MJEDISOR	11
5.1 BAZA LIGJORE E MONITORIMIT	11

1. HYRJE

1.1 NDIKIMET NE MJEDISE GJATE FAZES NDERTIMIT DHE PAS

Ky projekt është një investim i Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit Korce, per permisimin e kushteve teknike te mbrojtjes ekzistuese lumore dhe mbrojtjes se re nga Lumi Devoll ne Desare, ne Bashkine Cerrik.

Projekti dhe punimet qe do te kryhen ne rajon, do te ndihmoje ne mbrojtjen e bregut te lumit Devoll nga geryerjet dhe te tokave bujqesore qe shtrihen mbi kete breg, ne siperfaqe te kultivuara nga fermeret e zones.

Projekti synon riparimin e mbrojtjes egzistuese te shkateruar dhe mbrojtjen e brigjeve te lunit nga geryerjet para dhe pas mbrojtjes egzistuese, me qellim mbrojtjen e tokave bujqesore qe shtrihen ne Perendim te Lumit Devoll.

Gjate punimeve do te vihen re nje sere ndikimesh ne mjedis. Keto ndikime do te jene direkte, si zhurma ose pluhuri i makinerive gjate ndertimit, ose indirekte si zhvillimi ekonomik dhe ndryshimi i detyruar i perdorimit te tokes.


1.2 QELLIMI I PROJEKTIT

Projekti synon riparimin e mbrojtjes egzistuese te shkateruar dhe mbrojtjen e brigjeve te lunit nga geryerjet para dhe pas mbrojtjes egzistuese, me qellim mbrojtjen e tokave bujqesore qe shtrihen ne Perendim te Lumit Devoll, permes nje mbrojtjeje gjatesore.

2. VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE KARAKTERISTIKAT

2.1 TË PERGJITHSHME

Projekti është i fokusuar në ne Desare, pergjate rrjedhjes se Lumit Devoll, ne krahun e majte te rrjedhes se tij. Zona e projektit shtrihet ne nje terren fushor.



Vendodhja e Projektit

2.2 RELIEVI

Territori i bashkisë Cerrik karakterizohet nga format kodrinoro-fushore-malore. Parë në aspektin e relievit, bashkia ndahet në disa zona me karakteristika të ndryshme. Zona Lindore dhe Zona e lugines se Devollit ne Mollas paraqitet kryesisht fushore, zona Perendimore karakterizohet nga reliev kodrinoro – me nderthurje te tre formave te relievit.

2.3 ZONAT TONA TË INTERESIT:

Zona jone e interesit ndodhet ne Desare. Kjo zone ndodhet skajin Jug Perendimore te Bashkise Cerrik prane kufirit te saj me Bashkine Elbasan, pergjate rrjedhes se Lumit Devoll, ne krahun e majte te rrjedhes se tij..

2.4 RILEVIMI TOPOGRAFIK

Pas percaktimit ne bashkepunim me drejtorine e Ujitjes dhe kullimit Korce me sakesimin e zones te projektit, u kryhe nje rikonjicion i zones. Fillimisht ndertohet nje reliev me izoipse ku hartohet projekti. Modelimi i terrenit permban te gjitha karakteristikat si ato natyrale ashtu edhe ato te bera brenda zones se rilevuar. Per te kryer studimin topografik duhet të kryhet një rilevim topografik i kesaj zone (i relievit dhe kuotave të terrenit). te dhenat e te cilit perftohen ne kohe reale dhe zhvillohen lehtesisht ne kompjuter, ne baze te modelimit topografik te terrenit me GPS.

2.5 TE DHENAT HIDROLOGJIKE DHE KLIMATIKE

Mbrojtja e krahut te majte te lumit Devoll ne zonen e Desares ndodhet ne Lindje te fshtit Mollas dhe shtrihet pergjate krahut te majte te rrjedhes se lumit Devoll ne segmentet e ekspozuara nga geryerjet me gjatesi 600 ml.

Tereni ku do te mbrohet nga geryerjet eshte zone fushore me shtrirje ne kuotat 55-60 m mbi nivelin e detit, me pjeresi qe pergjithesisht kane drejtimim nga Lindja ne Perendim.

Pjeresia e tokave eshte e rrendit 0.15% ne drejtimin e rrjedhes.

Nga studimet e kryera ne zonen e Mollasit (matjet e kryera ne shpimet ne vite me shtrirje ne gjithe zonen), rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte i ndryshem.

Niveli i tij eshte ne varesi te rreshjeve te shiut qe bien ne periudha te ndryshme te vitit dhe ne varesi te nivelit te ujit ne lumin Devoll.

Ky nivel rezulton ne pjesen me te madhe te zones deri ne kuoten 2.0 m nen siperfaqen e tokes, kurse ne dimer dhe ne pranvere niveli i ujit nentokesor arin dhe deri 1.5 m nen siperfaqen e tokes.

Klima ne zonen e Mollasit eshte me dimer te bute dhe vere te thate e me temperature te larta qe shkone deri 40°C.

Muaji me i ftohte eshte muaji Janar dhe muaji me i nxehte eshte Gushti.

Lageshtia ajrore ne periudhen e Veres shkon deri 65 %-70.

Shpejtesia e eres ne Kohen e Veres shkon deri 1.2 m/sec.

Disa karakteristika te percaktuar nga studimet dhe matjet e Institutit Hidrometeorologjik te Shqiperise per zonen e poshtme te rrjedhes se lumit Devoll jane:

RAPORT MJEDISOR:
Objekti: "Mbrotjtje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, loti 2"

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Energjia diellore, kWh/m ² /dite	1.82	2.45	3.58	4.35	5.66	6.64	6.87	6.03	4.35	2.90	1.87	1.51
Temperatura, °C	-0.34	1.08	5.08	9.99	15.56	19.56	22.57	22.57	17.73	12.09	5.68	0.61
Shpejtesia e eres, m/s	3.94	4.14	3.92	3.73	3.22	3.19	3.25	3.34	3.31	3.64	3.92	4.17
Reshjet, mm	114	104	81	80	66	41	25	35	59	105	148	131
Ditet e lageshta, d	12.2	11.6	11.9	11.7	8.4	6.6	4.2	4.5	6.2	8.8	12.5	13.0

Sasite e shirave me te medha bien ne Pranvere dhe ne Vjeshte, te cilat perbejne problem per kullimin e tokave bujqesore, i cili realizohet nepermjet rrjetit te kanaleve kullues qe pershkojne te gjithë fushen.

Rreshjet vjetore mesatare dhe numri i diteve me shi ne kete zone jane si me poshte:

	Muajt												Shuma vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Rreshjet ne mm	159	164	135	117	109	66.4	44.3	35.7	89.1	115	195	122	1352
Nr. i diteve me shi	12.2	11.6	11.9	11.7	8.4	6.6	4.2	4.5	6.2	8.8	12.5	13.0	94.4

Lumi Devoll si dhe shumica e lumenjve te vendit tone eshte lume i tipit torrencial, me prurje qe luhaten ne nje diapazon te gjere gjate gjithë vitit.

Prurjet me te vogla vertetohen gjate muajve Qershor – Tetor dhe ato me te medhate ne muajt Tetor – Shkurt, qe ndjekin propocionalisht sasite e rreshjeve qe bien ne pellgun shimbledhes te lumit.

Prurjet mesatare vjetore te tij arrijne 120 m³/ sec, kurse Prurjet mesatare minimale arrijne 60 m³/sec.

Pas ndertimit te HEC te Banjes, rregjimi I prurjeve te lumit Devoll pas ketij HEC kane ndryshuar ne varesi te rregjimit te punes se ketij HEC-i , qe ne rastin e prurjeve te shkarkimit te muajve Nentor dhe Dhjetor te vitit 2025, mund te kene aritur deri 1200-1500 m³/sec, (prurje qe nuk jane konfirmuar zyrtarisht).

Reshjet mesatare shumëvjecare arrijnë deri 901 mm dhe reshjet maksimale jane rregjistruar ne gjate muajit Nentor. Ne tabelen jepen te dhenat mesatare per periudhen mesatare te njezet viteve te fundit.

Te dhenat Klimatike rrethin e Cerrik													
Mujore	Jan	Shk	Mar	Pril	Maj	Qers.	Kor.	Gus.	Shtat.	Tet.	Nënt	Dhj.	Totali
Rreshjet m	77	83	87	80	58	36	27	27	91	100	123	112	901

Tab Te dhenat e rreshjeve

Punimet rehabilituese qe do te realizohen ne kete zone kane per qellim mbrojtjen e tokave bujqesore nga Lumi i Devolls ,prane Fshatit Novosele.

RAPORT MJEDISOR:
Objekti: "Mbrotjtje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, loti 2"

Ne tabelat e meposhtme shfaqen dhe prurja mesatare nder vite te matura ne stacionet hidrometeorologjike perkatese dhe te perpunuara per perqindje sigurie te ndryshme.

Sasia e rreshjeve maksimale (ore)	Sasia e rreshjeve maks 2 vite	Sasia e rreshjeve maks 5 vite	Sasia e rreshjeve maks 10 vite	Sasia e rreshjeve maks 20 vite	Sasia e rreshjeve maks 50 vite	Sasia e rreshjeve maks 100 vite	Sasia e rreshjeve maks 1000 vite
1	34	43	65	77	93	104	142
2	45	68	83	98	117	131	177
6	74	116	145	172	207	233	320
12	102	149	180	209	247	276	370
24	136	193	231	267	314	349	465

Tab. Te dhena Historike te rreshjeve marre nga manuali i Shirave Maksimale me Siguri te Ndryshme ne zonen e Vlores, Instituti Hidrometeorologjik

KLIMA

Klima ne zonen e Mollasit, Cerrik është tipike mesdhetare me një dimër te lagësht e te ngrohte dhe me një vere te nxehte e cila arrin deri ne 40 grade.

Te dhenat Klimatike rrethin e Vlores													
Mujore	Jan	Shk	Mars	Prill	Maj	Qers.	Kor.	Gu.	Shtat.	Tet.	Nënt	Dhj.	Totali
Temp mes Larte °C	13.2	13.9	15.9	19.0	23.2	27.0	29.7	29.8	27.0	22.8	18.2	14.5	21.2
Temp mes Ulet °C	4.8	5.3	6.6	9.6	13.2	16.6	18.4	18.3	15.9	12.5	9.5	6.3	11.4

Tab Te dhenat klimatike

Temperature minimale e regjistruar ka qene ne vitin 1968, -7 °C ndersa persa i perket temperaturave maksimale ka qene ajo e regjistruar gjate viti 1987, 41.6 °C.

Ndersa ne grafikun e meposhtem shenohen te dhenat e temperaturave historike para viteve 1990.

RRESHJET


Reshjet mesatare shumëvjeçare arrijnë deri 951 mm dhe reshjet maksimale jane rregjistruar ne gjate muajit Nentor ne tabelen dy jepen te dhenat mesatare per periudhen mesatare te njezet viteve te fundit.

Te dhenat Klimatike rrethin e Cerrikut													
Muaji	Jan	Sh k	Mar s	Pri ll	Ma j	Qer s.	Ko r.	Gu .	Shta t.	Tet.	Nën t	Dhj.	Tota li
<u>Rreshjet</u> mm	113. 5	86. 3	90.4	65. 3	56. 8	19.1	12. 4	21. 1	69.2	124. 1	138. 4	145. 0	941. 6

Tab Te dhenat e rreshjeve.

PROJEKTI

Projekti i mbrojtjes nga lumi Devoll do te zgjidhe mbrojtjen e brigjeve para dhe pas mbrojtjes egzistuese te realizuar ne fazen e pare me mbrojtje gjatesore me gabiona dhe blloqe betoni dhe ne riparimin e segmenteve te shkateruara ne mbrojtjen egzistuese sipas segmenteve:



Segmenti 1:

Mbrojtja ne segmentin 1 do te realizohet me mbrojtje gjatesore me gabiona me gure ne gjatesine 70 ml.

Mbrojtja do te kete lartesine $H=4$ m dhe realizohet me 4 rreshta me lartesi rreshti 1 m.

Pas mbrojtjes depresioni i krijuar nga mendri i lumit do te mbushet me gure me madhesi te barabarte ose me te madhe se 50 cm, me qellim nderprerjen rruges se lumit te krijuar nga meandri , per te siguruar qe rrjedha e lumit te mos kaloje pas mbrojtjes se re dhe asaj egzistues, gje qe do te shkateronte si mbrojtjen e re dhe ate egzistuese.

Segmenti 2 dhe 3.

Mbrojtja ne keto segmente parashikon riparimin e mbrojtjes egzistuese te fazes se pare ne segmentet 2 me gjatesi 74 ml dhe ne segmentin 3 me gjatesi 20 ml.

Kjo mbrojtje do te realizohet me ndertimin e rreshtit te kreut te mbrojtjes egzistuese me gabiona me gure kavoje me permasa $1 \times 1.5 \times 2$ m, duke zevendesuar bloloqet e betonit te shkateruara gjate prurjeve te lumit.

Segmenti 4.

Mbrojtja ne kete segm,ent me gjatesi 70 ml do te realizohet me mbrojtje me gure me $D>50$ cm ne forme argjinature, me gjeresi ne kurore $B=3$ m dhe me pjeresi te skarpatave 1:2 ne bjefin e poshtem, nga ana e shtratit te lumit dhe me pjeresi 1:1.5 nga bjefi i siperm

Segmenti 5.

Mbrojtja ne segmentin 5 do te realizohet me mbrojtje gjatesore me gabiona me gure ne gjatesine 100 ml.

Mbrojtja do te kete lartesine $H=4$ m dhe realizohet me 4 rreshta me lartesi rreshti 1 m.

Perzgjedhja e Vendit per Ngritjen e Kantierit

Perzgjedhja e vendit te kantierit duhet te behet ne bashkepunime me Mbikqyresin e punimeve si dhe me autoritetet e pushtetit lokal dhe me Zhvilluesin e Punimeve Drejtorine e Ujitjes dhe Kullimit Korce.

Vendi i perzgjedhur duhet te jete larg banesave dhe te mos kete impakt negativ ne mjedisin e zones. Pozicioni i kantierit duhet te jete ne nje pike ku nuk nderhyn ne jeten dhe aktivitetin e perditshem normal te banoreve. Gjithsesi pozicionimi i kantierit duhet te jete efikas dhe i shpejte ne cdo pike te objektit. Kantieri i ngritur duhet te jete i pajisur me:

- Rruge lidhese me rrugen ekzistuese
- Te jete i rrethuar, dhe te pajisur me tabelat informuese.

Ne perfundim te punimeve sipërfaqja dhe zona perreth kantierit duhet te rikthehen ne gjendjen e meparshme.

2.6 Makineritë dhe pajisjet kryesore që do të përdoren për projektin.

Pajisje dhe makineritë kryesore që do përdoren gjatë fazës së ndërtimit janë zakonisht ato të përdorura në një projekt ndërtimi dhe përfshijnë:

- Eskavatore per germim, mbushje e ngjeshje;
- Kamioncin per transport materiali ndertimi dhe punetori;
- Rul per ngjeshje.



Figure. Disa nga Makinerite e Ndertimit te Cilat do te perdoren

Nga aktivitetet ne kantier nuk do te ketë gjenerim te ujërave të ndotura apo mbetje.

3. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne zonen e projektit

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis i projektit të propozuar është bërë gjykuar mbi faktorët që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e funksionimit, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha nën kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis është analizuar sipas fazave të veprimtarisë si më poshtë:

Sipas natyrës ndikimet klasifikohen në dy grupe të mëdha:

- Ndikime të kthyeshme;
- Ndikime të pakthyeshme;

Për të vlerësuar ndikimet e pritshme në mjedis grupi hartues është bazuar në:

- Analizimin e zbatimit të projektit ;
- Përputhshmëria e plotë projekti me ligjet dhe rregulloret përkatëse;
- Ndikimi nga projekti në kushtet sociale-ekonomike të komunitetit pritës dhe shëndeti i banorëve;

Gjatë fazës ndërtimore do gjenerohen mbetje inerte ndërtimi por edhe mbetje urbane nga aktiviteti njerezor i punonjësve që operojnë për ndërtimin e objektit. Kjo sasi do të depozitohet në vend depozitimit të miratuara nga pushteti lokal.

Sasia e mbetjeve të gjeneruara do jete kryesisht mbetje dhera nga gërmimi , apo shtresa betoni të thyera. Keto mbetje nuk vlerësohet të jene domethenese dhe jane mbetje te riciklueshme e cila mund të menaxhohet lehtësisht nga stafi i kantierit të cilët janë të interesuar të përdorin me efikasitet këto produkt .

Për të përcaktuar më mirë masat për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative të identifikuara gjatë procesit të VNM, në këtë paragraf është bërë një kategorizim i rëndësishëm së çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis të projektit. Ky kategorizim është kryer bazuar në vlerat mjedisore të zonës, legjislacionin mjedisor në fuqi dhe njohuritë mbi teknologjinë dhe teknikën e kryerjes së operacioneve ndërtimore.

Percaktimi i ndikimeve në tabelën e mëposhtme u realizuar nga projekti teknik dhe përfaqësja e ndikimeve të mundshme që mund të lindin gjatë fazave të ndryshme të tij dhe nga vlerësimi i ndjeshmërisë së mjedisit.

Indikatorët mjedisor	Faza e ndërtimit të Rehabilitimit të Mbrojtjes lumore	Faza e Shfrytëzimit të Mbrojtjes lumore
Toka	2	3
Ndotja e ujit	2	3
Ndotja e ajrit	2	0
Flora/Fauna	0	4
Zhurma	2	0
Sociale-Ekonomike		
Punesim	4	3

RAPORT MJEDISOR:
Objekti: "Mbrotjtje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, loti 2"

Ekonomia	3	4
Trashegimi kulturore	0	0
Siguria ne Rruge dhe akses	2	3
Prodhimi/Produkt Bujqesore	2	3

0- Nuk ka ndikime

1- Ndikime negative te rendesishme

2- Ndikime negative mesatare

3- Ndikime pozitive te rendesishme

4- Ndikime pozitive mesatare

3.1 Toka

Duke pasur parasysh toka e gërmuar mund të ngjeshet nga mjetet e rënda dhe mund të ketë disa rrjedhje të substancave ndotëse (Naftë, vaj, benzinë, , etj), të cilat vijnë nga mjetet e përdorura gjatë punimeve të ndërtimit, kjo gjë mund të sjellë një ndikim negativ mesatar.

Pas rehabilitimit rritet siguria ndaj erozionit dhe kemi një ndikim pozitiv.

3.2 Ndotja e ujit

Duhet verejtur prania e plumbit, zinkut dhe ndotësve të tjerë nga mjetet sic janë vaj, benzinë dhe lëndë toksike) të cilat mund të depertojnë në shtresat ujembajtëse të zonës ose në rrjedhjet afër saj. Gjithashtu duke parë dhe moshën relativisht të lartë të mjeteve që mund të përdoren karburantëve me plumb mund të ketë ndikim negativ.

Në ujërat sipërfaqësor apo nëntokësor mund të shkaktojnë dhe ndikim mesatare negative.

3.3 Ndotja e ajrit

Nisur nga gjendja ekzistuese e rrugës dhe nga karakteristika e punimeve që do të realizohen në zonë, do të ketë një ndotje ajri mesatare kryesisht nga pluhuri që do të krijohet gjatë punimeve dhe nga gazrat e lëshuara nga to. Ekipit të ndërtimit do t'i rekomandohet të kontrollojë lëshimin e emisioneve të gazrave dhe nëse punimet do të realizohen gjatë sitës së thatë të marrim masa për të ulur nivelin e pluhurave në ajër të shkaktuara nga germimet.

3.4 Zhurmat

Zhurma nga aktiviteti i ndërtimit mund të shqetësojë zonat përreth zonës së projektit . Kjo mund të kontrollohet duke kufizuar punën gjatë orarit të ditës, megjithatë zona e projektit ka fare pak zona banuara. Por kemi zhurmat nga trafiku pasi ndodhet në afërsi të një rruge objekti dhe nga përdorimi i makinerive të rënda gjatë punimeve.

3.5 Flora/ fauna

Duke vezhguar ndikimet në florë dhe faunë, sepse ne kete zone ka habitate të mirëfillta, zona ne pjesen me te madhe është zonë rurale . Nuk kemi nje fragmentim te mirefillte te habitatit dhe kalim ne zona te virgjera.

3.6 Sociale-economike

Pas fazes se ndertimit do kemi siguri per mosgeryerjen e tokave bujqesore qe shtrihen ne krahun e majte te rrjedhes se lumit Devoll ne zonen qe mbrohet ne Desare.

4. Qëllimet e monitorimit mjedisor

Qëllimi i monitorimit mjedisor të projektit është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit gjatë dhe në mbyllje të tij.
- Të monitorojë emetimet në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në zonen e projektit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të projektit nëzonë.
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në zonën e projektit, në rastetkur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.

4.1 Baza ligjore e monitorimit

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

RAPORT MJEDISOR:
Objekti: "Mbrojtje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, loti 2"

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 "Për mbrojtjen e mjedisit", kreu VI "monitorim i gjendjes së mjedisit"; Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet elejes përkatëse mjedisore.

Legjislacioni bazë ku mbështetet monitorimi janë:

Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji 162/2014"	Per Mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin eProgramit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre. I ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriterete zonimit të mjedisve ujore pritëse.
Ligj nr. 10463 dt. 22.09.2011	Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet:
"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit tëndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar imbetjeve;

Në përputhje me karakteristikat e projektit dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente:

Programi i Monitorimit

Nr	Indikatorët e Monitoruar	Çfarë parametri do të monitorohet?	Koha e monitorimit	Frekuenca e monitorimit?	Per gje gjes i a
----	--------------------------	------------------------------------	--------------------	--------------------------	------------------

RAPORT MJEDISOR:
Objekti: "Mbrotjtje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, loti 2"

1	Materialet , mbetje të gjeneruara ngaprocesi i gërmimeve (dhera , inerte , etj)	Sasia, tipi i materialit (mbetjes së gjeneruar), depozitimi në sheshdepozit im.	Gjatë periudhës se ndërtimit/gërmimev e ,në cdo kohë që do kemi gjenerim mbetjesh	Rregullisht	Zhvilluesi i projektit
2	Emetimi i zhurmave ne(dB)	Niveli i zhurmave tëmetuara në dB	Faza ndërtimore Matja e zhurmave me kontraktore të akredituar (përfshirë parametrin e zhurmavetë akredituar)	Sipas kushteve të vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	Zhvilluesi i projektit
3	Emetimi i Pluhurave Pluhurat	Niveli i(PM10 ;PM2.5;TSP) Ne ambjentet e punes dhe ne periferi të sheshit të ndërtimit	Vezhgime e terren mbinivelin e pluhurit. Matje e Pluhurit totalne ambjentet e punes dhe periferi me kontraktore të akredituar (sipas kushteve të vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedisit)PM10 & TSP ne	Sipas kushteve të vendosura në Vendimin për Vlerësim Paraprak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	Zhv illu esi i proj ekti t
4	Raste , aksidente/inci dente potenciale të mundshme që shoqërohen me kontaminime të tokës	Regjistrohen / menaxhimi dhe përgjigja/ reagimi pas cdo kontaminimi /incidenti të mundshëm të ndodhur si dhe pasojat që ka shkaktuar incidenti.	Faza ndërtimore	Sipas rasteve nëse do kemi incidente të tilla	Zhv illu esi i proj ekti t
5	Monitorim i kushteve të vendosura në Vendimin për Vlerësim	Monitorohen Rregjistrohe n Raportohen Referuar kushteve	Faza ndërtimore	Sipas kushteve te vendosura në	Zhv illu esi i proj

RAPORT MJEDISOR:
Objekti: “Mbrotjtje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, loti 2”

	Paraparak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	tevendosura në Vendimin për Vlerësim Paraparak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)		Vendimin për Vlerësim Paraparak të Ndikimit në Mjedisit (nga Insitucionet e mjedisit)	ekti t
--	--	---	--	--	-----------

“ARGI” sh.p.k.
Digitally signed by
ing. Ljamb Tarka